



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E KAÇANIKUT
DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE DHE EMERGJENCËS
07Nr. _____/14
Kaçanik, 01. 12. 2014



Bazuar në nenin 83 të Statutit të Komunës së Kaçanikut, Rregullores për Transport Rrugor në territorin e komunës së Kaçanikut 01 - Nr. 07 - 344 – 32032 / 14 të datës 31. 10. 2014, nenit 62. 3 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Drejtoria e Emergjencës dhe Shërbimeve Publike, bënë këtë:

SHPLLJE PUBLIKE

Për vazhdimin dhe ndarjen e vijave të transportit publik të udhëtarëve dhe lëshuarën e lejeve të punës për operatorët me autobus, kombi bus dhe auto taksi për vitin 2015

1. Për linja me autobusë dhe kombi-bus në vijat ku nuk operojnë autobusët, mund të aplikojnë në:

- | | |
|--------------------------------|--------------------------------|
| 1. Kaçanik - Kovaçec | 12. Kaçanik – Kaçanik i Vjetër |
| 2. Kaçanik – Biçec | 13. Kaçanik - Begracë |
| 3. Kaçanik – Nikaj | 14. Kaçanik - Stagovë |
| 4. Kaçanik – Rekë | 15. Kaçanik – Duraj – Gabrricë |
| 5. Kaçanik – Imisht (Dubravë) | 16. Kaçanik – Semajë |
| 6. Kaçanik – Soponicë | 17. Kaçanik - Kotlinë |
| 7. Kaçanik – Sepetin (Dubravë) | 18. Kaçanik - Ivajë |
| 8. Kaçanik – Strazhë | 19. Kaçanik - Gajre |
| 9. Kaçanik – Gllloboçicë | 20. Kaçanik – Bajnicë |
| 10. Kaçanik – Doganaj | 21. Kaçanik - Runjevë |
| 11. Kaçanik – Elezaj | 22. Kaçanik - Gërllicë |

2. Kushtet për pajisje me Licencë (Leje Pune) për transport publik të udhëtarëve:

Leja e punës për autobusë mund të jepet, nëse aplikuesi i plotëson këto kriterë:

- Aplikacioni,
- Të ketë në pronësi së paku dy (2) autobus,
- Të ketë të punësuar së paku një shofer profesionist të kategorisë “D”,
- Një mekanik për mirëmbajtje, respektivisht kontratën me servis për mirëmbajtje të autobusëve,
- Biznesin e regjistruar në MTI,
- Selinë e kompanisë në territorin e komunës sonë,
- Të mos ketë ndalesa juridike për ushtrimin e veprimtarisë.
- Certifikata e mjekut, për shoferë të autobusëve,
- Patentë shoferi për kategori “D” (kopje) e vërtetuar nga organi komunal (të ketë më tepër se dy vite përvojë),
- Librezat e qarkullimit për autobusët (kopje) të vërtetuara nga organi komunal,
- Të ketë të kryera obligimet komunale,
- Rendi i Udhëtimit (orari i nisjes - kthimit), të vërtetuara nga drejtoria,
- Kontratën për peronimin e autobusëve për nisje dhe kthim,
- Pagesa për leje pune vjetore 100 € dhe vërtetim të rendit të udhëtimit 25 €.

2.1 Dy minibusë - në terrenet ku nuk mund të operojnë autobusët, për shkak të konfiguracionit të terrenit.

3. Leja e punës për operator me kombi bus me 8+1 ulëse do të jepet në linjën në të cilën nuk mund të operoj autobusi dhe minibusi dhe aplikuesi duhet të plotëson këto kritere:

- a) Aplikacioni,
- b) Patentë shoferi (kopje)
- c) Të posedoj patentë shoferin më të vjetër se 5 vite,
- d) Të ketë në pronësi së paku dy kombi bus me 8+1 ulëse,
- e) Të jetë banor i komunës së Kaçanikut,
- f) Të posedoj certifikatën e regjistrimit të biznesit,
- g) Të mos ketë pengesa juridike për ushtrimin e veprimtarisë,
- h) Kontratën për peronim për nisje dhe kthim,
- i) Të ketë të kryera obligimet komunale,
- j) Certifikata e mjekut,
- k) Dëshmi për sigurimin e pasagjerëve,
- l) Taksa për leje pune 30 € dhe vërtetimi i rendit të udhëtimit 25 €.
- m) Dy fotografi.

4. Leja e punës për taksi veturë (4+1) mund të jepet, nëse aplikuesi i plotëson këto kritere:

- a) Aplikacioni,
- b) Letërnjoftimi (kopje),
- c) Libreza e qarkullimit (kopje),
- d) Të posedoj patentë shoferin më të vjetër se pesë (05) vite të kategorisë “B”,
- e) Automjeti të ketë pesë (05) dyer,
- f) Automjeti të ketë 4+1 ulëse,
- g) Automjeti të ketë taksimetër,
- h) Të posedoj certifikatën e regjistrimit të biznesit,
- i) Të jetë pronar i automjetit me të cilin ushtron këtë veprimtari,
- j) Automjeti të ketë të vendosur firmën “TAXI” në pjesën e përparme të kulmit të automjetit, e cila duhet të ndriçoj natën,
- k) Aplikuesi nuk mund të jetë i punësuar në institucione publike dhe private,
- l) Të mos ketë pengesa juridike për ushtrimin e veprimtarisë,
- m) Të ketë të kryera obligimet komunale,
- n) Të kryej pagesën prej 35 € për marrjen e lejes së punës,
- o) Certifikata e mjekut,
- p) Dëshmi për sigurimin e pasagjerëve,
- q) Dy fotografi.

5. Leja e punës për Kompani Taksi – Operator Taksi, mund të jepet, nëse aplikuesi i plotëson këto kritere:

- a) Aplikacioni,
- b) Të ketë selinë në territorin e komunës së Kaçanikut,
- c) Të ketë certifikatën e regjistrimit të biznesit,
- d) 4. Të ketë së paku tri (03) automjete në pronësi, me ngjyrë të njëjtë (librezat e qarkullimit – kopje),
- e) Të gjithë shoferët e punësuar, të posedojnë patentë shoferin më të vjetër se pesë (05) vite,
- f) Të ketë vendparkim, frekuenca, zyrë, lidhje telefonike dhe kontratën apo servisin për mirëmbajtje të automjeteve,
- g) Të mos ketë pengesa juridike për ushtrimin e veprimtarisë,
- h) Të paguhet taksa në shumë prej 100 €,

- i) Të ketë të kryera obligimet komunale,
- j) Certifikata e mjekut,
- k) Dëshmi për sigurimin e pasagjerëve,
- l) Dy fotografi.

Afati për paraqitjen e aplikacioneve do të jetë 15 ditë, nga dita e publikimit.

Në mungesë të dokumenteve të kërkuara, kërkesa do të refuzohet.

Dokumentet e kompletuara duhet të dorëzohen në zyrën e pranimi.

Për më shumë informacione dhe për marrjen e aplikacionit, mund t'i drejtoheni Drejtorisë për Emergjencë dhe Shërbime Publike.

Vërejtje: Të gjithë operatorët në vija të rregullta të Transportit Publik të Udhëtarëve, me: Autobus dhe Kombi- Bus, krahas dokumentacionit të lartshënuar, duhet të paraqesin edhe çmimet e mujoreve dhe biletave, sipas Rendit të Udhëtimit, pasi që çmimorja e paraqitur do të vërtetohet edhe nga drejtoria përkatëse.

z. Shkelqim Jakupi
drejtor i DESHP-së
